



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-111/01-17799
Datë 15.04.2026

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika b të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 81 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 08/L-294 dhe nenin 12 të Rregullores (QRK) numër 30/2024 për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni i Pranimit për zhvillimin e procedurës së vlerësimit për pozitën Zyrtar për Teknologji Informative sipas konkursit me numër 01-111/01-17632 të datës 15.04.2026.
2. Komisionin e Pranimit nga pika 1 e këtij vendimi e përbëjnë:
 - 2.1. Jeta Haraçia – Kryesuese (Zyrtar i Lartë për Burime Njerëzore)
 - 2.2. Armend Haziri – Anëtarë (U.D. Udhëheqës i Sektorit të SISH)
 - 2.3. Ali Sadiku – Anëtarë (Udhëheqës i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Orize)
 - 2.4. Gentiana Çollaku – Anëtare (Doktor i Mjekësisë)
 - 2.5. Artan Myha – Anëtarë (Doktor i Stomatologjisë)

Zëvendësues të anëtarëve të komisionit:

- 2.1. Trëndelina Shehu Hasi – Kryesuese (Zyrtar i Lartë për Burime Njerëzore)
 - 2.2. Teuta Vokshi – Anëtare (Udhëheqës i Sektorit të Administratës në QKMF)
 - 2.3. Bekim Hyla – Anëtarë (Udhëheqës i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Skivjan)
 - 2.4. Elidijana Morina – Anëtare (Doktor i Mjekësisë)
 - 2.5. Vala Kastrati – Anëtare (Doktor i Stomatologjisë)
3. Komisioni i Pranimit ka për detyrë dhe përgjegjësi që të bëjë vlerësimin profesional të kandidatëve që përfshin testimin me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i kandidatëve apo teknikë tjetër ekuivalente dhe të përshtatshme për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale, si dhe intervistën me gojë në përputhje me dispozitat e Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 08/L-294 dhe Rregulloren (QRK) numër 30/2024 për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit të Pranimit
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit